

## KONTRATA PËR SHIT – BLERJEN E KUOTAVE

Sot më datë 10 / 02 /2021 (dymijë e njetzetënje), lidhet kjo kontratë për shitblerjen e kuotave, me pjesëmarrës:

### PALËT:

#### Shitesi :

1. **Znj. Zemrite Skeja**, lindur me 15.12.1969, mbajtes i kartes se identitetit me nr. G96215034A me date leshimi 22.01.2019 dhe **Znj. Zana Memeti**, lindur me 13.09.1962, mbajtes i kartes se identitetit me nr. G25913113J me date leshimi 04.04.2019, aksionere te shoqerise **VitalMed Shpk**, me nipt M11318006B, me adrese te selise Njesia Bashkiake nr 4, rruga e Dibres, pallati nr 417, Tirane.

*këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar si “SHITËSI”*

#### Blerësi :

2. **Individi Z. Tomorr Mustafaj**, shtetas shqiptare, lindur me 01.04.1993, mbajtes i pasaportes me nr. J30401120D me date leshimi 23.02.2011, madhor dhe aftesi te plote juridike per te vepruar ligjerisht..

*këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar si “BLERËSIT”*

### MEQËNËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE

- Shoqëria Tregtare **“VitalMed” Sh.p.k** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila është rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tirane, Shqipëri më datë 18/01/2021 me numër NIPT : **M11318006B** me adresë të selisë: **Rruga Dibres, Pallati Nr. 417, Njesia me nr pasurie 7/928/ND-N3, Tirane, Shqipëri.**





- Shoqëria ka një kapital të regjistruar, tërësisht të nënshkruar dhe të paguar, në shumën **1,000,000 (njemilion) lekë** i cili zotërohet nga ortakët e shoqërise si vijon :  
Shoqëria **VitalMed**, Shpk, e regjistruar me nipt M11318006B, me adrese të selise Rruga e Dibres, Pallati nr 417, e cila përfaqësohet me **50% të pjesës të kapitalit të shoqërise nga Znj. Zemrite Skeja dhe 50% të pjesës së kapitalit të shoqërise nga Znj. Zana Memeti**, ashtu si dhe përcaktuar në Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Shitësi në këtë kontratë, **Znj Zemrite Skeja**, e cila zotëron **50 %** të pjesës së kapitalit themeltar të shoqërise, me vlerë nominale 500,000 Leke dhe **Znj Zana Memeti** e cila zotëron **50%** të pjesës së kapitalit themeltar të shoqërise, me vlerë nominale 500,000 Leke sipas negociatave dhe marrëveshjeve paraprake të palëve, kanë vendosur të transferojnë **100 %** të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërise tek blerësi:
- Blerësi **z. Tomorr Mustafaj**, dëshiron të blejë prej shoqërise **individëve të siperpërmendur** në cilësinë e Shitësit, **100 %** të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërise **“VITALMED” Sh.p.k** për vlerën e tyre nominale prej **1,000,000 Leke**. Pas blerjes së përqindjes së kapitalit themeltar prej **100%**, ortakët **z. Tomorr Mustafaj** do të ketë një pjesëmarrje në kapitalin e shoqërise prej **100 %** dhe do të zotërojë 1 (një) kuotë me vlerë nominale **1,000,000 Leke**, sipas kushteve e termave dhe afateve të mëposhtme të kësaj Kontrate.

Sa më sipër, palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë vijon :

## NENI 1

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është transferimi nga Shitësi tek Blerësi, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë kontratë, të kuotes dhe çdo të drejtë që i përket kuotes, të lira nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, dhe blerësi blen kuotën sipas kësaj Kontrate .

VitalMed Sh.p.k.  
M11318006B  
TIRANË - ALBANIA

Me transferimin e Kuotave , blerësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë deri ne daten e kalimit te kuotave te shoqerise "VITALMED" SHPK .

Ortaket e shoqërisë VITALMED SHPK perkatesisht **Znj. Zemrite Skeja** e cila zotëron **50 %** të kapitalit të shoqerisë dhe posedon 1 (një) kuotë me vlere nominale **500,000 Leke** dhe **Znj.Zana Memeti** e cila zoteron **50%** te kapitalit te shoqerise dhe posedon 1(nje)kuote me vlere nominale **500,000leke** e cila do të shitet në këtë mënyrë :

- **Znj Zemrite Skeja** dhe **Znj Zana Memeti** do t'i shesin individit **Z. Tomorr Mustafaj 100 % te pjeseve te kapitalit fillestar te shoqerise "VITAL MED " Sh.p.k** Tirane, kundrejt vlerës së tyre nominale prej **1,000,000 (njemilion) lekë**. Pas shitjes se perqindjes se kapitalit prej **100 %** , ortaku i ri **Z. Tomorr Mustafaj do te kete nje pjesemarrje ne kapital prej 100 % dhe do te zoteroje 1 (nje) kuote me vlere nominale 1,000,000 Leke.**

## NENI 2

### ÇMIMI I BLERJES DHE METODA E PAGESËS

Çmimi i blerjes për kuoten është në vlerën **1,000,000 (njemilion) Leke** për të cilin palët kanë rënë dakort. Çmimi i vendosur nga palët në këtë kontratë përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kuota e transferuar.

Pagesa e çmimit të blerjes së kuotes do te behet ne pagese kesh ndermjet paleve.

## NENI 3



### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTES

Kuotat e shitura sipas kësaj kontrate do kalojë në pronësi të blerësve më datë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Shitësit **Znj.Zemrite Skeja dhe Znj.Zana Memeti** humbasin pronësinë mbi **100 %** te pjeseve te kapitalit te shoqerise "VITALMED " Sh.p.k duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë.

Ndërsa Blerësit, **z. Tomorr Mustafaj**, behet zoterues i masës prej **100 %** të kapitalit të shoqërisë, te perfituara nepermjet kuotes se blere sipas kushteve te caktuara te kesaj kontrate.

## NENI 4

### DETYRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN



Përveç ndonjë veprimi tjetër për tu ndërmarrë dhe të ndonjë instrumenti tjetër për tu nënshkruar dhe/ose dorëzuar në përputhje me këtë Kontratë, për *transferimin* e kuotes :

**a) Shitësi do të:**

i. Dorëzohet të gjithë dokumentacionin ligjor të shoqërisë me të cilin vërtetohen nënshkrimi rregullisht dhe shlyerja e kuotes të kapitalit themeltar;

ii. Nënshkruajë dhe dorëzohet dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e instrumentave të tjera që mund të jenë të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për t'i kaluar Blerësit pronësinë e lirë nga çdo barrë apo pretendim të çdo lloji, qoftë nga persona fizik apo juridike, privatë apo publikë.

iii. Dorëzohet të gjithë dokumentacionin ligjor dhe financiar të shoqërisë në disponim të kësaj të fundit i cili është perditesuar deri në datën e kalimit të kuotes.

**Dhe**

**b) Blerësi do të:**

i. Paguaj të plotë çmimin e Blerjes në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate në shumën dhe në mënyrën e caktuar në nenin 3 të kësaj kontrate;

ii. Do të marrë në dorëzim të gjithë dokumentacionin e shoqërisë sipas pikave i) dhe iii) të gërmës a) të këtij neni.

Në përfundim, Blerësi fiton titullin mbi kuoten në Datën e Transferimit. Blerësi do të depozitohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit ("QKB ") Kontratën e Shitjes dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për të bërë të mundur transferimin e pronësisë së 100% (njeqindperqind ) të kuotes së kapitalit themeltar të Shoqërisë.

**NENI 5**

**DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT**

***Shitësi i deklaron dhe i garanton Blerësit sa më poshtë;***

VitalMed Sh.p.k.  
M11318006B  
TIRANË - ALBANIA

a. Shoqëria "VITALMED" Sh.p.k, është një Shoqëri e organizuar dhe që funksionin në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe ka autoritet dhe kompetencë të plotë për të drejtuar veprimtarinë e saj, të zotërojë aktivet që ka tashmë në zotërim. Shoqëria është liçensuar sipas rregullave në fuqi të kryejë veprimtari sipas objektit të saj të përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

b. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë në datën e transferimit është **1,000,000 (njemilion) lekë** dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlere nominale ne total **1,000,000 (njemilion) leke**.

Gjithë vlera e kuotes së kapitalit të regjistruar të Shoqërisë është shlyer tërësisht.

## NENI 6

### DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

*Blerësit deklarojnë dhe garantojnë Shitësit si më poshtë:*

a. Blerësi ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontratë dhe të zbatojë transaksionet e miratuara nga kjo Kontratë.

b. Blerësi ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të përfunduar këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e miratuara në kete kontrate ne perputhje me ligjin.

## NENI 7

### AUTORIZIME TË TJERA

7.1 Blerësi do të paraqese dhe/ose eshte në procedurë e sipër për të paraqitur, në mënyrë të rregullt pranë Autoriteteve Qeveritare – duke përfshirë këtu, për të mënjeluar çdo dyshim, Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës dhe çdo kërkesë për miratim nga Autoritetet Qeveritare, ose njoftim ligjor që mund të jetë i nevojshem për kryerjen e këtij transaksioni perfshire organet tatimore dhe institucionet e tjera shqiptare.

## NENI 8

### LIGJI QË DO TË ZBATOHET DHE JURIDIKSIONI

#### 8.1. Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të

VitalMed Sh.p.k.  
M11318006B  
TIRANE - ALBANIA

rregullohet sipas dispozitave të legjislationit tregtar dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

### **8.2. Zgjidhja e Konfliktëve**

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të palëve në këtë kontakt. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane..

## **NENI 9**

### **GJUHA E KONTRATËS**

Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe e përbërë nga 6 (gjashte) faqe dhe është përgatitur në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

## **NENI 10**

### **ANEKSET E KONTRATËS**

Kësaj kontrate i bashkëngjiten si anekse të cilat do konsiderohen pjesë integrale dhe të pandashme të saj dokumentat e mëposhtme:

1. Vendimi i Asamblese se ortakeve te shoqërisë "VITALMED" Sh.p.k .
2. Ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit;

Palet e gjejnë të rregullt këtë Kontratë dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e firmosin unanimisht.

**PALËT**

Shitesi i kuotes

Zemrite Skeja

Zana Memeti



**BLERESI**

Tomorri Mustafaj